

LIGJ
Nr. 10/2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9863, DATË 28.1.2008,
“PËR USHQIMIN”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 11 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve hartohet Strategjia Kombëtare e Sigurisë Ushqimore, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo strategji rishikohet çdo 7 vjet.”.

Neni 2

Në nenin 16 bëhen ndryshimi dhe shtesat si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kontrolli i përputhshmërisë së dokumentacionit shoqërues, sipas nenit 18 të këtij ligji, të ngarkesave të ushqimeve të importuara me kërkesat e legjislacionit shqiptar kryhet në Pikat e Inspektimit Kufitar nga inspektori i institucionit përgjegjës të kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Inspektori vendos bllokimin e ngarkesës dhe masa të tjera të parashikuara në këtë ligj ose në aktet nënligjore në zbatim të tij kur dokumentacioni shoqërues nuk është në përputhje me kërkesat ligjore.”.

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Në rast të marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe kontrolli i përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni mund të kryhet sipas parashikimeve të përcaktuara në marrëveshje.

5. Rregullat dhe procedurat e kryerjes së kontrollit zyrtar sipas këtij neni përcaktohen me udhëzim të ministrit.”.

Neni 3

Në nenin 17 bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 1 pas fjalisë së parë shtohet fjalia e dytë me këtë përmbajtje:

“Në rastin e pikës 4 të nenit 16 të këtij ligji procedurat doganore kryhen pasi inspektori i ushqimit dhe ushqimit për kafshë jep miratimin.”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Shpenzimet për kontrollin zyrtar, për marrjen e mostrës dhe kryerjen e analizave laboratorike përballohen nga importuesi, me përjashtim të parashikimeve të marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe me vendet eksportuese, ku në kushte reciprociteti mund të mos aplikohen tarifa.”.

Neni 4

Në nenin 38 paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Tarifat për marrjen e mostrave, kryerjen e analizave, kontrollin zyrtar në PIK dhe për pajisjen me dokumentin që vërteton sigurinë e ushqimeve miratohen me udhëzim të ministrit. Në rast të marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe zbatohen dispozitat e marrëveshjeve, dhe në kushte reciprociteti mund të mos aplikohen tarifa.”.

Neni 5

Në nenin 51, pas pikës 7 shtohen pikat 8 dhe 9 me këtë përmbajtje:

“7. Parashikimet e pikës 4 të nenit 16 të këtij ligji për kontrollin dhe pikës 1/1 të nenit 17 të këtij ligji për procedurat doganore aplikohen edhe në importin e ushqimit për kafshë. Shpenzimet për kontrollin zyrtar për ushqimin për kafshë, marrjen e mostrës dhe kryerjen e analizave laboratorike përballohen nga importuesi, me përjashtim të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe me vendet eksportuese.

8. Procedurat e kryerjes së kontrollit zyrtar përcaktohen me udhëzim të ministrit.”.

Neni 6

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 1 të tij.

2. Ngarkohet ministri që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 2 dhe 5 të tij.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar ë datë 27.1.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13478, datë 16.2.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.